



Arben Merkoçi is currently ICREA Professor and director of the Nanobioelectronics & Biosensors Group at *Institut Català de Nanociència i Nanotecnologia* (ICN2). After his PhD (1991) at Tirana University (Albania), in the topic of Ion-Selective-Electrodes (ISEs) Dr. Merkoçi worked as postdoc and senior researcher/invited professor in the field of nanobiosensors and lab-on-a-chip technologies in Italy, Spain, USA and since 2006 at ICN2. Prof. Merkoçi research is focused on the design and application of cutting edge nanotechnology and nanoscience based cost/efficient biosensors. The paper/plastic-based nanobiosensors involve integration of biological molecules (DNA, antibodies, cells and

enzymes) and other (bio)receptors with micro- and nanostructures/motors and applied in diagnostics, environmental monitoring or safety and security. He has published around 250 peer review research papers, supervised around 25 PhD students and has been invited to give plenary lectures and keynote speeches in around 100 occasions in various countries.

### **Shqip:**

Profesor Arben Merkoçi mbaroi studimet në Universitetin e Tiranës, dhe prej vitit 1993 shkoi për studime postdoktorature (Itali, Spanjë, SHBA) dhe aktualisht, jeton dhe punon në Barcelonë. Ai mban titullin Profesor ICREA (një nga 255 titujt e dhënë në të gjitha fushat në krahinën e Katalunjës). Prof. Merkoçi është drejtuesi i Grupit Shkencor të Nanobioelektronikës dhe Biosensorëve në Institutin Katalan të Nanoshkencës dhe Nanoteknologjiose (ICN2) në Barcelonë, Spanjë. Fusha e tij e kërkimit shkencor është nanoteknologjia dhe biosensorët. Ai është studjues i aparaturave e paisjeve të reja të bazuara në nanogrimca e nanomateriale, integrimin e tyre në mikro/nanoplataforma mikrofluidike plastike apo celuloze me interes për diagnostikimin e sëmundjeve (kancer etj) apo monitorime ambientale dhe aplikime të tjera në fushën e sigurisë. Është kordinuesi i më se 50 projekteve kombëtare spanjolle dhe ndërkombëtare duke përfshirë programet e Komunitetit Europian (FP5, FP6, FP7, H2020), NATO etj. Është anëtar në komisione ndërkombëtare të vlerësimit të projekteve si ekspert në fushën e tij, udhëheqës i 25 doktoratave (PhD-ve) të mbrojtura nga studentë të vëndeve të ndryshme të botës. Prof. Merkoçi është Anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe fitues i çmimeve ndërkombëtare duke përmendur këtu medaljen (Nano Award) dhënë në 2011 nga IAAM (Intern. Assoc. Advanced Materials). Ka qënë i ftuar për të dhënë konferenca plenare në më shumë se 150 kongrese në të gjithë botën. Prof. Merkoçi është Editor i revistës më prestigjioze të biosensorëve (Biosensors and Bioelectronics: me faktor impakti IF 7, 47) dhe anëtar i bordit të revistave të tjera të fushës së tij (Electroanalysis, Microanalysis, Cancer Nanotechnology etj.). Prof. Merkoçi ka publikuar (deri në Prill 2017) më se 260 artikuj në revista ndërkombëtare dhe ka një H-indeks të publikimeve në Web of science: 48; dhe në Google scholar: 57, me më shumë se 13000 citime.

### **CV e plote e Prof. Merkoçi:**

<http://www.nanobiosensors.org/wp-content/uploads/2011/09/Full-CV-AMerkoçi-2015.pdf>.